REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, datë 20.10.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	**KRASNIQI**	**Kryetar**
Desada	**METAJ**	**Zëvendëskryetar**
Aurela	**BICJA**	**Anëtar**
Besian	**ZOGAJ**	**Anëtar**
Gjergji	**HAMITI**	**Anëtar**
Jetmir	**HALILAJ**	**Anëtar**
Joana	**ALLUSHI**	**Anëtar**

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rrëzimin e propozimit për heqjen e licencës së shoqërisë "Radio Alsion" sh.p.k, për subjektin audio privat "Radio Club Alsion". **(Vendim nr. 108, datë 20.10.2026)**
2. Heqjen dhe konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit së shoqërisë "Tv Kabllor Vlora Cable" sh.p.k, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Vlora Cable", për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare dhe përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tij më datë 01.09.2026 pa u rinovuar. **(Vendim nr. 109, datë 20.10.2026)**
3. Pranimin e aplikimit të shoqërisë "Fabbtel" sh.p.k, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve online, mbështetur në rrjet (IP) IPTV "Fabbtel", duke vendosur zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në: *"Bashkinë Divjakë dhe Cërrik dhe Njësinë Administrative Paper (të bashkisë Elbasan)"*. **(Vendim nr. 110, datë 20.10.2026)**
4. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë "APT Cable" sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor APT", në "*Qarkun Korçë*". **(Vendim nr. 111, datë 20.10.2026)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 20 tetor 2026